



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Seksioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit

Mbledhja e mbajtur me 16.04.2013, duke filluar në orën 11:00

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, kryetar, Albulena Haxhiu, Behar Selimi, Gëzim Kelmendi dhe Mufera Sinik, anëtarë.

Munguan: Ardian Gjini dhe Jasmina Zivkovic, anëtarë

Nga Zyra mbështetëse moren pjesë: Fehmi Hyseni, Advie Morina;

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 3 Shqyrtimi i Projektligjit për te Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit.;
4. Te ndryshme;

Shqyrtimi lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projekt-rregullores e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Armend Zemaj-Theksoi se raporti I cili është siguruar

Nënkomisioni, sa i përket ligjit për deputetet, e kemi diskutuar dhe analizuar gjatë. në vazhdim theksoi se duhet të behet parallogaritja e kostos buxhetore për te gjitha legjislaturat e Kuvendit të Kosoves, edhe ato para luftës (1990, 1992, 1997). Njeherit ka pohuar se deputetët që janë të rij me moshë nuk janë të interesuar që ta shtyjnë përpara çështjen e pensionit suplementar për dallim nga deputetet më të moshuar. Nëse nuk

duhet te ketë pension për deputet, atëherë nuk do te duhej te ketë as për presidentin, Gjykatën Kushtetuese, atë Supreme apo FSK-në, si dhe për zyrtaret e cilave gëzojnë pensione të tilla në bazë të funksionit që ushtrojnë.

Ne duhet te vendosim standarde te njëjta dhe nuk duhet te funksionojmë me standarde te dyfishta, duke e parë te nevojshme që ky projektligj t'i procedohet Kuvendit në mënyrë që të merret mendimi i shumice për çështje pensionit suplementar.

Ne vazhdim Kryetari- tha se disponimi i anëtareve te Nenkomisioni është që ligji te mos jete diskriminues, te jetë gjithë përfshirës. Është diskutuar dhe shqyrtimi i nenit 19, i cili parasheh qe deputeti tek i cili gjatë ushtrimit te detyrës se tij , është shkaktuar paaftësia e përgjithshme për punë, ka te drejtë në pension pa marrë parasysh moshën dhe kohen e ushtrimit te detyrës si dhe për imunitetin e deputetit i cili parashihet ne nenin 25. nga se edhe ketë e ka kundërshtuar Gjykata Kushtetuese.

Albulena Haxhiu- ka ripërsëritur edhe njëherë qëndrimin e subjektit te saj politik se pensionet e tilla për deputet si dhe mosha e hershme e pensionimit të tyre janë çështje të papranueshme dhe një padrejtësi që po tenton që të iu behet qytetarëve te Kosoves. Gjendja ekonomike dhe sociale në të cilën jemi, është fyerje për qytetarët që ne të kemi privilegje te tilla. Në jemi ne një situatë të vështirë, 45 për qind të popullatës janë të papunë dhe në të kërkojmë pension suplementar. Ajo ka rikujtuar se po ashtu edhe Gjykata Kushtetuese e ka hedhur poshtë pensionin suplementar duke e konsideruar se nuk është ne përputhje me standardet ekonomike dhe sociale te vendit. Ajo ka diskutuar edhe për çështjen e imunitetit te deputetit, duke konsideruar se deputetet duhet te kenë imunitet të plotë meqë ata janë 24 orë deputet.

Behar Selimi-edhe pse personalisht ka përkrahur qëndrimin e deputetes Haxhiu lidhur me pensionet, sa i përket opinionit të grupit parlamentar, ai ka thënë se ata kanë tjetër mendim. Ne e kemi draftuar ligjin , ne mendojmë se këto dispozita duhet të diskutohen ne Kuvend me keto dispozita dhe më pas le të shkojë në procedurë. Deputetet mund ta amendamentojnë dhe ta votojnë, edhe pse personalisht mendoj se kjo çështje duhet të zgjidhet ma vonë.

Gëzim Kelmendi- nga radha e koalicionit pa ashtu e kundërshton një pension të tillë, duke vlerësuar se deputetet edhe pa te janë shumë te privilegjuar. Ai ka cekur se deputetet nuk duhen ta përkrahin pensionin suplementar, por duhen te solidarizohen moralisht me pensionistet për të cilët ka thënë se marrin ndihmë sociale.

Sipas tij, krahasuar me pagën mesatare të vendit, deputetet në Kosovë marrin paga ma të larta se deputetet e vendeve të BE-së. Lidhur me zyrtarët e kategorive të tjera që gëzojnë beneficione jashtë mandatit të tyre, ai tha se nuk duhet te merret si model i mirë. Duhet edhe ligjet tjera te ndryshohen dhe te behet harmonizimi i tyre.

Në fund, kryetari Zemaj propozoi përfundimin, që çështjen e Projektligjit për te Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit; ta diskutojë me shefat e grupeve parlamentare për te vendosur lidhur me procedimin te mëtejshëm për seancën plenare.

Te ndryshme

Nenkomisioni u pajtua që mbledhjet të mbahen sa ma shpesh me qëllim që të përfundohet sa ma parë varianti përfundimtar i Projektligjit për te Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit.

Mbledhja përfundoi ne ora 12.30.

Kryetar i Nenkomisionit

Armend Zemaj

